

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit K.S. A. W. Zvicër, të cilin e përfaqësojnë B.N. dhe G. D., avokatë nga Prishtina, kundër të paditurës K.S. "I." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizimi I. H., , për kompensim të dëmit - rimbursimit nga sigurimi i auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 42.243,41 €, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.40/2015 datë 12.11.2015, në seancën e mbajtur më 24.3.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.40/2015 datë 12.11.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.40/2015 datë 12.11.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.544/2013, datë 23.12.2014, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit që të detyrohet K.S. "I." me seli në Prishtinë që paditësit t'ia kompensojë shumën prej 42,243.41 €, në emër të rimbursimit nga sigurimi i auto-përgjegjësisë, me kamatë prej 12% në vit, duke llogaritur nga data 14.1.2010 deri te pagesa definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit t'ia paguajë shumën prej 2,218.60 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të aprovohet si i bazuar, ashtu që aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në raport kontraktues me të siguarin G. R. AG, pronar i automjetit "...", me trarga ..., mbi bazën e auto-sigurimit kasko, sipas policës së sigurimit ..., e vlefshme deri më 4.10.2009. Më 10.6.2009 ka ndodhur një aksident trafiku në rrugën magjistrale Ferizaj-Kaçanik ndërmjet automjetit të siguar kasko dhe kamionit të markës "...", i cili ka bërë lëvizje të pasigurt prapa (rikvers), duke mos verifikuar nëse kishte ose jo automjete prapa dhe me atë rast, me pjesën anësore të majtë, e godit automjetin e siguar kasko ("...", me trarga ..., të cilin e drejtzonte Xh. I.) dhe e hedh jashtë rrugës, duke i shkaktuar dëme të mëdha materiale. Paditësi, si sigures kasko, në emër të kompensimit të dëmit nga aksidenti, i ka paguar të siguarit të tij shumën prej 64.768,00 CHF. E paditura, pas shqyrtimit të ekspertizës së trafikut, ka deklaruar se nuk e konteston kërkesëpadinë për nga baza juridike, ndërsa objekt shqyrtimi në procedurën e mëtejme ka qenë shuma mbi të cilën paditësi ka të drejtën e rimbursimit. Sipas ekspertizës teknike për vlerësimin e dëmit në automjet dhe plotësimin të ekspertizës nga Mr.sc.N. Sh., është vërtetuar fakti se dëmi total i konvertuar kap një shumë prej 37.575,22 €, ndërsa paditësi, përveç kësaj shume, ka kërkuar edhe shumën prej 3.718 CHF, në emër të transportit të automjetit të aksidentuar dhe shumën prej 1.858,75 €, në emër të shfrytëzimit të një automjeti tjetër si renta-car.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për sa i përket shumës së përgjithshme prej 42.243,41 €, si vlerë reale në emër të rimbursimit dhe e ka obliguar të paditurën ashtu siç përshkruhet më hollësisht në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e zhvilluar me rastin e ankesës, e ka pranuar si të drejtë e të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për miratimin e kërkesëpadiës së paditësit, pasi më parë është vërtetuar në mënyrë të sigurt përgjegjësia e të paditurës për rimbursimin e borxhit kontestues, në shumën e aprovuar, duke refuzuar pastaj ankesën si të pabazuar dhe duke vërtetuar aktgjykimin e ankimuar.

Thëniet në revizionin e të paditurës se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse nuk përmban arsye lidhur me pretendimet e ankesës, veçanërisht kur kihet parasysh që, sipas tyre, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë nuk arsyetohet dhe nuk shpjegohet se për vërtetimin e fakteve relevante cilat prova janë administruar, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të sigurt se ekziston përgjegjësia e të paditurës për rimbursimin e borxhit kontestues si dhe qëndron shuma e miratuar e këtij borxhi. Kjo Gjykatë shton se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e saj e ka mbështetur në provat të cilat i ka administruar në shqyrtimin kryesor, duke arsyetuar me hollësi se me cilën provë i ka vërtetuar faktet jo kontestuese dhe ato kontestuese. Gjykata e shkallës së dytë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e ankimore të së paditurës, duke vlerësuar se ato nuk qëndrojnë, mbasi ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK.

Pretendimet e cekura në revizion se gjykatat e instancës më të ulët kanë aplikuar në mënyrë të gabuar dispozitat e nenit 190 dhe 200 të LMD, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara, ngase e paditura nuk e ka kontestuar faktin se ekziston përgjegjësia e saj për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga i siguruari i saj ditën e aksidentit, por ka kontestuar shumën e kompensimit, të cilën gjykatat e instancave më të ulëta e kanë vërtetuar në bazë të ekspertizës teknike mbi vlerësimin e dëmtimit të automjetit dhe plotësimin e ekspertizës nga eksperti Mr.sc. N. Sh., i cili, në bazë të propozimit të së paditurës është ftuar për të bërë sqarime në shqyrtimin kryesor, ndërsa e paditura nuk i ka kundërshtuar konstatimet e ekspertit dhe nuk ka propozuar nxjerrjen e ndonjë ekspertize tjetër. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 190 të LMD, ngase me prova konkrete kanë caktuar një shumë reale për dëmin e shkaktuar me rastin e aksidentit, shumë kjo që nevojitet për ta sjellë gjendjen materiale të të dëmtuarit aty ku do të ishte po të mos kishte pasur veprim dëmtues.

Gjykatat e instancave më të ulëta e kanë konstatuar shumën e dëmit në bazë të ekspertizës teknike të kryer nga eksperti që kishte në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm lidhur me dëmtimin e automjetit, duke vlerësuar si “dëm total ekonomik”, ndërsa nga kalkulimi janë hequr pjesët e mbetura të automjetit në vlerë prej 8.000 CHF, si pjesë që kanë mundur të përdoren apo të shitën, kështu që pretendimi i të paditurës i ngritur në revizion se është zbatuar në mënyrë të gabuar neni 200 i LMD, u vlerësua si i pabazuar, ngase gjykatat e të dyja shkallëve, masën e dëmit e kanë caktuar në mënyrë reale, duke i marrë për bazë të gjitha kriteret e përcaktuara me këtë nen, duke pas parasysh peshën e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, prandaj sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykatat në fjalë e kanë zbatuar drejt dispozitën e ligjit material, duke obliguar të paditurën që, në emër të rimbursimit nga auto-përgjegjësia, paditësit t’ia paguajë shumën e cekur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart dhe në bazë të nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
E.Rev.nr.14/2016, më 24.3.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku